



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-152

**PËR ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË FONDIN MONETAR
NDËRKOMBËTARË DHE ORGANIZATAT E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 17, 18, 19 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË FONDIN MONETAR
NDËRKOMBËTARË DHE ORGANIZATAT E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE**

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të rregulloj procedurat dhe autorizimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për anëtarësimin e shtetit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore, mbi bazën e dokumentit të këtyre institucioneve monetare.

Neni 2

Qeveria e Republikës së Kosovës (tash e tutje i referohemi si “Qeveria”) është e autorizuar të pranojë, në emër të Republikës së Kosovës, (tash e tutje i referohemi si “Kosova”), anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar (tash e tutje i referohemi si “Fondi”), në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (tash e tutje i referohemi si “Banka”), Korporatën Financiare Ndërkombëtare (tash e tutje i referohemi si “Korporata”), Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (tash e tutje i referohemi si “Shoqata”), në Agjencinë për Garantimin e Investimeve Multilaterale (tash e tutje i referohemi si “Agjencia”), dhe në

Qendrën Ndërkombëtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të Investimeve (tash e tutje i referohemi si IKSID) duke pranuar nenet përkatëse të marrëveshjes së Fondit, Bankës, Korporatës dhe të Shoqatës, siç është ndryshuar, Konventës për themelimin e Agjencisë për garantimin e investimeve multilaterale (tash e tutje i referohemi si Konventa AGIM) dhe konventa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera (tash e tutje e referohemi si Konventa IKSID), tekstet e të cilave janë dhënë në anekset I, II, III, IV, V dhe VI të këtij akti dhe duke pranuar termet dhe kushtet e Rezolutave të Bordit përkatës të Guvernatorëve të Fondit, Bankës, Korporatës dhe të Shoqatës, Këshillit të Guvernatorëve të Agjencisë dhe Këshillit Administrativ të IKSID lidhur me anëtarësimin e Kosovës në këto organizata.

Neni 3

1. Me pranimin e Kosovës për anëtarësim në Fond, Kosova me këtë rast autorizohet të jetë pjesëmarrëse në Departamentin Special për të Drejtat e Tërheqjes.
2. Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozim të Kryeministrit, do të caktojë përfaqësuesin e autorizuar të ekzekutojë dhe depozitojë në Fond, në emër të Kosovës, një Instrument të pjesëmarrjes duke u zotuar që Kosova të ndërmarr të gjitha obligimet e pjesëmarrjes në Departamentin Special për të Drejtat e Tërheqjes së Fondit, të veprojë në emër të Kosovës në këtë departament në pajtim me ligjin e Kosovës duke autorizuar që Kosova të ndërmarr të gjitha hapat e nevojshëm që të kryejë të gjitha obligimet e pjesëmarrësit në Departamentin Special për të Drejtat e Tërheqjes.

Neni 4

1. Qeveria, është e autorizuar nga Kuvendi i Kosovës të huazojë apo të kërkojë me cilëndo mënyrë, dhe të paguajë në emër të Kosovës shumat që janë për t'u paguar herë pas herë në Fond, Bankë, Korporatë, Shoqatë dhe Agjenci, sipas termave dhe kushteve të Rezolutës, lidhur me anëtarësimin e Kosovës në organizatat e parapara në nenin 2 të këtij ligji dhe sipas neneve dhe marrëveshjeve përkatëse apo Konventës, dhe të bëjë pagesat, në raport me pjesëmarrjen e Kosovës, në Departamentin Special për të Drejtat e Tërheqjes së Fondit.
2. Qeveria, me këtë rast, është e autorizuar të nxjerrë, në pajtim me nenet dhe marrëveshjet e Fondit, Bankës, Shoqatës, dhe Konventës AGIM, çdo dëftesë të pa negociuar, e që nuk sjellë interes, që mund të jenë të domosdoshme apo të duhura në aspektin e anëtarësimit të Kosovës në Fond, Bankë, Shoqatë, apo Agjenci.

Neni 5

1. Banka Qendrore e Kosovës (tash e tutje i referohemi si "Banka Qendrore") do të shërbejë si agjencia fiskale, siç është paraparë në nenin V, paragrafi 1 të nenit të Marrëveshjes së Fondit,

dhe në këtë mënyrë është e autorizuar të kryej, në emër të Kosovës, të gjitha operacionet dhe transaksionet e autorizuar, me dispozita të ndryshme, të neneve të Marrëveshjes së Fondit.

2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të shërbejë si agjenci fiskale, siç kërkohet me nenin III, paragrafit 2 i Neneve të Marrëveshjes me Bankën dhe është i hartuar si kanal komunikimi që i referohet nenit IV, paragrafit 10 të neneve të Marrëveshjes me Korporatën, neni VI, paragrafi 10 i Neneve të Marrëveshjes të Shoqatës, dhe neni 38 i Konventës që e formon Agjencinë.

Neni 6

Banka Qendrore është themeluar si thesar për të mbajtur parat e Fondit, Bankës, Korporatës, Shoqatës, dhe Agjencisë.

Neni 7

1. Banka Qendrore ka të drejtë të marrë, në emër të Kosovës çfarëdo shume që mund të paguhet apo të transferohet në Kosovë, në operacionet dhe transaksionet e autorizuar, nën dispozitat e neneve mbi Marrëveshjen e Fondit.

2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave përmes departamentit të thesarit, do ta ketë të drejtën të marrë çfarëdo shume në emër të Kosovës që mund të paguhet apo transferohet për Kosovë në operacionet dhe transaksionet e autorizuar nën dispozitat e neneve të Marrëveshjes së Bankës, Shoqatës dhe Korporatës si dhe Konventës AGIM.

Neni 8

Presidenti i Kosovës, me propozim të Kryeministrit, do të caktojë përfaqësues të autorizuar për të nënshkruar në emër të Kosovës, dokumentet origjinale të neneve të Marrëveshjes së Fondit, Bankës, Korporatës dhe Shoqatës, Konventës AGIM dhe Konventës IKSID dhe të ekzekutojë e të depozitojë çfarëdo instrumenti të pranimit, instrumentin e ratifikimit, si dhe dokumenteve të tjera që mund të kërkohen për pranimin e anëtarësimit në këto organizata.

Neni 9

Dispozitat e neneve të Marrëveshjes së Fondit dhe të Bankës, Korporatës, Shoqatës, Konventës AGIM dhe të Konventës IKSID të përcaktuara në Aneksat I, II, III, IV, V dhe VI në këtë ligj, do ta kenë fuqinë e plotë në Kosovë:

(1) fjalia e parë e nenit VIII, duke përfshirë seksionin 2(b), neni IX, Seksioni 2 deri 9, dhe neni XXI (b) i neneve mbi Marrëveshje me Fondin;

(2) Neni VII duke përfshirë Seksionin 2 deri 9 i neneve mbi Marrëveshje me Bankën;

- (3) Neni VI, Seksioni 2 deri 9 i neneve mbi Marrëveshje me Korporatën;
- (4) Neni VIII, duke përfshire Seksioni 2 deri 9 i neneve mbi Marrëveshje me Shoqatën;
- (5) Kapitulli 7, nenet 44 deri 48 te Konventës qe themelon AGIM:
- (6) Kapitulli I, Seksioni 6, nenet 18 deri 24 i Konventës IKSID.

Neni 10

Qeveria e Kosovës, do të nxjerr rregullore dhe akte të tjera nënligjore që janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të cilat do të hartohen nga Ministria kompetente si dhe do të ndërmerren aktivitete të tjera, në mënyrë që t'i zbatojë obligimet e Kosovës nga nenet e Marrëveshjes, Konventave, dhe Rezolutave të parapara në nenin 2 më lartë, që të kenë fuqinë dhe efektin e vetë të plotë për dispozitat e këtij ligji.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi ditën publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-152
29 maj 2009**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI